



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 699/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar , z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Mileković - anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “AS Tech” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Sabri Azemi B.I”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e komunës dhe objektet tjera komunale”, me numër të prok:616-19-4043-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Komuna e Prishtinës, më datë: 04.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “AS Tech” SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e komunës dhe objektet tjera komunale”, me numër të prok:616-19-4043-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Komuna e Prishtinës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e komunës dhe objektet tjera komunale”, me numër të prok:616-19-4043-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Komuna e Prishtinës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “AS Tech” SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Afati për dorëzimin e ofertës ka qenë deri më : 05.07.2019.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 13.06.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues: 27.09.2019.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt: 02.10.2019.

Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim bërë me dt: 04.10.2019.

Operatori ekonomik ankues: “AS Tech” SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 14.10.2019 , me nr. 699/ 19 , kundër njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e komunës dhe objektet tjera komunale”, me numër të prok:616-19-4043-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 60 dhe nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.10.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.10.2019 sqaron si në vijim :

Përgjigje në **Pretendimi nr. 1** Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk ka sjelle dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata të natyrës së ngjashme në 3 vitet e fundit prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë, lidhur me listën e kontratave të prezantuar nga OE “Raketa” (Sabri Azemi B.I.) OE i është lëshuar referenca nga menaxheri i projektit se ka përfunduar kontratën në tetor 2017 ndërsa në kohën kur është lëshuar referenca kontrata ka

gene ende aktive, madje OE ka kryer shërbime edhe ne vitin 2018 nga kontrata e njëjtë. Gjithashtu, duke marr për baze kërkesën nga AK nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, tek Kapaciteti teknik dhe profesionale po citoj: “OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata te ngjashme ne tri vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimi te njoftimit në vlerën minimale prej 50,000.00€. Dhe dëshmia e kërkuar: 1. Lista e projekteve të përfunduara në tri vitet e fundit për kontrata te ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve, duke plotësuar Aneksin 6.” Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme sqarojë se pretendimet e palës ne ankese, nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me **pretendimin nr.2**, se AK nuk ka kërkuar sqarime për çmimet jo-normalisht te ulëta te disa pozicioneve te dhëna ne paramasë si p.sh.: Pozicioni 2. Furnizimi dhe montimi i klimës split BTU 9000 R410 me çmim 110 euro, ndërsa çmimi i blerjes për këtë pajisje është 210.50 euro, (e gjeni te bashkangjitur katalogun), pastaj Pozicioni 6. Furnizimi me kondicioner kanalor ngrohje 65000/ftohje 60000, Btu/h me çmim 250 euro, ndërsa çmimi i tregut është te paktën 1,990.50 euro (e gjeni te bashkangjitur katalogun). OE ka bere manipulim me çmime, përparësia e ekzekutimit te kontratës se kaluar dhe marrja e informacioneve se cilat pozicione janë me te kërkuara nuk arsyeton dhënien e çmimit jo-normalisht te ulët dhe nuk mund te pranohet i tille nga Komisioni i vlerësimit për këtë tender. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën e procedurës së prokurimit, bazuar ne nenin 4.2 Procedura e shqyrtimit (interpartes) në Rregulloren për tender Jo-Normalisht të Ulët, po citoj: “Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë ab-normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". Eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 61 të LPP-së, përkatësisht paragrafit 2 te nenit 4 te Rregullores për çmime Jo-Normalisht te ulëta, AK-ja ka mundur te trajtoj si çmime jo-normalisht te ulëta dhe te zhvilloj te gjitha procedurat (Inter Partes) për çmimet për te cilat ka mundur te dyshoj se janë çmime Jo-Normalisht te ulëta duke krahasuar me manualet e çmimeve refrenet te nxjerr nga KRPP-ja, kontratat e lidhur më parë nga Komuna e Prishtinës apo/ose duke analizuar çmimet e tregut. Prandaj në bazë të sqarimeve te mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës ne ankese ne këtë pikë janë pjesërisht të qëndrueshme. Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron si ne vijim: Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje çmimin, apo te konsiderohet si jo

normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57. Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, si çështje të gjykuara “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Prandaj, në bazë të analizës së mësipërme sqarojë se pretendimet e palës në ankese, nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuara në dosjen e tenderit, raportin e vlerësimit, platformën elektronike si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankese e OE: “AS Tech” Sh.p.k., për tenderin e AK: Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale", me nr. prokurimi: 615-19-4043-1-2-1, rekomandon që ankese e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, (për arsye që u cek tek përgjigja në pretendimin si më lartë) dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimi të autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 24.10.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 24.10.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 04.11.2019, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së, si dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkrësat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të

ofertave, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit kontraktues, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrirat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Fetoshi i cili deklaroj: Ne qëndrojmë në tërësi pran pretendimeve tona ankimore dhe konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta në pozicione të ndryshme si p.sh: tek Poz. nr 2. Ku është parashikuar furnizimi dhe montimi i klimës SPLIT BTU 9000 R410 ka ofruar çmim 110 euro ndërsa çmimi i tregut i blerjes për këtë klimë sillet rreth 210 euro d.m.th me këtë pozicion OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar skajshmërisht çmime me të ulët me çmimet e tregut. Po ashtu në pozicionin nr 6. Furnizimi me kondicioner OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim 250 euro ndërsa çmimi i tregut sillet 1.990 euro. Ne kemi marrë oferte në lidhje me këto çmime nga Kompania VIVAX të cilat i prezantojmë panelit shqyrtues si dëshmi se sa janë çmimet për këto pozicione që i cekem.

Ne nuk jemi në dijeni dhe nuk kemi asnjë informacion se si i ka arsyetuar OE i rekomanduar për kontratë këto çmime dhe nuk kemi dëshmi konkrete se a kanë kërkuar sqarime shtesë në lidhje me këto çmime e që për mendimin tonë këto çmime janë absurde dhe njëkohësisht manipulative ndërsa nëse merren çmimet e tregut parasysh në atëherë nuk kemi ide si do të realizohet kjo kontratë me këto çmime.

Pretendim tjetër në lidhje me OE e rekomanduar është se nuk ka plotësuar kërkesat në lidhje me kontratat dhe referencat për 3 vitet e fundit konkretisht e kemi kontestuar një kontratë e që ka të bëjë me vetë Autoritetin Kontraktues- KK-PRISHTINE e cila kontratë është nënshkruar më 12.10.2016 e që kjo kontratë është kontratë kornize 36 muaj ndërsa OE të rekomanduar për kontratë i është lëshuar një reference kinse ka përfunduar kontratën në muajin tetor të vitit 2017, prandaj kjo konsiderohet se kjo nuk mund të merret parasysh sepse ka të bëjë me një kontratë kornize 36 muaj. Duke u bazuar në dëshmitë e cekura në ankese kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe ky AP të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Mekolli i cili deklaroj: Kjo lende është për herë të dytë në OSHP andaj ju përkujtoj se në vendimin paraprak të datës 11.09.2019 asnjëra nga pikat pretenduese të OE ankues nuk kanë qenë të aprovuara e edhe vendimi i juaj që lenda të kthehet në rivlerësuar besoj që ka qenë një vendim teknikisht i gabuar. Autoriteti Kontraktues prapë se prapë duke u mbështetur dhe respektuar vendimin e datës 11.09.2019 ka formuar komisionin dhe ka bërë rivlerësim dhe ka rivlerësuar ofertat, komisioni i rivlerësimit në përbërje të re, me përpikëmeri ka bërë rivlerësimin e ofertave duke u munduar që mos të lëshojë gabim në mënyrë që lenda mos të vijë prapë në OSHP për Rishqyrtim dhe për kundër asaj që në vendimin tuaj të datës 11.09.2019 nuk është kërkuar të kërkojnë sqarime tjera shtesë nga ndonjë organ tjetër apo OE i rekomanduar për kontratë për çmime jo-normalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave ka pranuar informata nga drejtoria e financave për pagesat e bëra për OE-në “Raketa” dhe në bazë të

dëshmime të ofruara nga Drejtoria e Financave rezulton se referenca e kontestuar nga OE ankues është valide dhe se kontrata për pastrimin e filtrave të ajrit dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e ri të Komunës është kontratë e përfunduar me kohe. Dëshmi këto i kemi dorëzuar në OSHP të cilat janë me data. Po ashtu komisioni për rivlerësimin e ofertave ka kërkuar informata nga OE “Raketa” për 2 pozicione për të cilat OE ankues thirret se janë çmime jo normalisht të ulëta dhe sqarimet e marra nga OE “Raketa” janë sqarime bindëse për Autoriteti Kontraktues andaj edhe komisioni për ri-vlerësimin e Ofertave prapë vendos që të rekomandon për kontratë OE-ne “Raketa”. Panelit i dorëzoi edhe parashtresat ku është bërë komunikimi me OE-ne e rekomanduar për kontratë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Beqiri deklaroi: Sa i përket pretendimit të parë është sqaruar në raportin e parë dhe e plotëson këtë kriter, sa i përket çmimeve jo normalisht të ulëta nuk kam parë informata që kanë kërkuar nga OE. Qëndroj prapa mendimit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovoj ankesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Mekolli deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që këtë lende ta marr si çështje të gjykuar dhe ti jepet e drejta që të vazhdoj me tutje me vendimin Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se ankesa është parashtruar kundër njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Lidhur me **pretendimin nr. 1** të operatorit ekonomik ankues “AS Tech” SH.P.K-Prishtinë, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, “Sabri Azemi B.I”-Prishtinë, nuk ka sjelle dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontratë të natyrës së ngjashme në 3 vitet e fundit prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë, dhe se kur OE i është lëshuar referenca kontratë ka qenë ende aktive, madje se OE ka kryer edhe shërbime në vitin 2018 nga kontratë e njëjtë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit vlerëson se autoriteti kontraktues gjatë ri-vlerësimit ka respektuar vendimin PSH. nr. 473/19, të datës:11.09.2019, dhe ka vërtetuar referencat e operatorit ekonomik të rekomanduar për

kontratë, andaj në harmoni me nenin 7, dhe 59, LPP-së rekomandon për kontratë operatorin ekonomik i cili i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu, Paneli shqyrtues, konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se ky pretendim ankimor është çështje e gjykuar “*res judicata*”, sepse janë plotësuar 3 kushtet e përcaktuar ne nenin 105.2 .16 te LPP-se, respektivisht nenin 16 paragrafi 2) dhe 3) të Rregullores Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit . Pra, janë 1) përsëritur pretendimet ankimore te njëjta, 2) objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, dhe 3) rasti është shqyrtuar me parë. Neni 105.2.16 i LPP-se përcakton “*Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”*”.

Lidhur me pretendimin nr. 2 te operatorit ekonomik ankues “AS Tech” SH.P.K-Prishtinë, se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarime për çmimet jo-normalisht te ulëta te disa pozicione te dhëna ne paramasë si p.sh.: Pozicioni 2. Furnizimi dhe montimi i klimës split BTU 9000 R410 me çmim 110 euro, ndërsa çmimi i blerjes për këtë pajisje është 210.50 euro, (e gjeni te bashkangjitur katalogun), pastaj Pozicioni 6. Furnizimi me kondicioner kanakor ngrohje 65000/ftohje 60000, Btu/h me çmim 250 euro, ndërsa çmimi i tregut është te paktën 1,990.50 euro (e gjeni te bashkangjitur katalogun). I njëjti pretendon se OE ka bere manipulim me çmime, përparësia e ekzekutimit te kontratës se kaluar dhe marrja e informacioneve se cilat pozicione janë me te kërkuara nuk arsyeton dhënien e çmimit jo-normalisht te ulet dhe nuk mund te pranohet i tille nga Komisioni i vlerësimit për këtë tender.

Paneli shqyrtues, konform ekspertit profesional të prokurimit, sqaron se sipas nenit 61 të LPP-së, përkatësisht paragrafit 2 te nenit 4 te Rregullores për çmime Jo-Normalisht te ulëta, AK-ja ka mundur te trajtoj si çmime jo-normalisht te ulëta dhe të zhvilloj të gjitha procedurat (Inter Parties) për çmimet për te cilat ka mundur te dyshoj se janë çmime Jo-Normalisht te ulëta duke krahasuar me manualet e çmimeve referente te nxjerra nga KRPP-ja, kontratat e lidhur më parë nga Komuna e Prishtinës apo/ose duke analizuar çmimet e tregut. Prandaj në bazë të sqarimeve te mësipërme pretendimet e operatorit ekonomik ankues ne këtë pikë janë pjesërisht të qëndrueshme.

Paneli shqyrtues, konform ekspertit profesional të prokurimit, sqaron se është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht te komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje çmimin, apo ti konsideroj si jo normalisht te te ulta në pajtim me nenin 61 të LPP-së.

Paneli shqyrtues, konform ekspertit profesional të prokurimit, sqaron se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues, konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se ky pretendim ankimor është çështje e gjykuar *“res judicata”*, sepse janë plotësuar 3 kushtet e përcaktuara në nenin 105.2.16 të LPP-së, respektivisht nenin 16 paragrafi 2) dhe 3) të Rregullores Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Pra, janë 1) përsëritur pretendimet ankimore të njëjta, 2) objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, dhe 3) rasti është shqyrtuar më parë. Neni 105.2.16 i LPP-së përcakton *“Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtojë si çështje të gjykuar “res judicata”*.

Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE - “AS Tech” SH.P.K-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi

